

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Menaxher i Zyres Teknike

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Menaxheri i Zyrës Teknike është përgjegjës për koordinimin dhe menaxhimin e të gjithë dokumentacionit teknik të projektit të ndërtimit, mbikëqyrjen e procesit të projekteve ekzekutive, kontrollin e vizatimeve dhe specifikimeve teknike, si dhe koordinimin midis projektuesve, kontraktorëve dhe ekipit të kantierit për të siguruar zbatimin korrekt të projektit.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Menaxhon dhe koordinon aktivitetet e Zyrës Teknike në zbatimin e projektit.
- Kontrollon dhe verifikon vizatimet teknike, projektet ekzekutive dhe specifikimet teknike para fillimit të punimeve.
- Koordinon komunikimin teknik ndërmjet HQ dhe Kantierit.
- Përgatit dhe menaxhon RFI (Request for Information), dorëzimet dhe dokumentacion teknik.
- Ndjek dhe kontrollon ndryshimet në projekt (variacionet) dhe përgatit dokumentacionin përkatës.
- Menaxhon shop drawings/implementation drawings dhe as-built drawings dhe dokumentacionin final të projektit.
- Mbështet menaxhimin e projektit në planifikimin teknik dhe zgjidhjen e problemeve teknike.
- Koordinon përgatitjen e raporteve teknike dhe progresit të punimeve.
- Siguron arkivimin dhe menaxhimin korrekt të dokumentacionit teknik të projektit.

❖ KRITERET KRYESORE

- Diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi.
- Minimumi 5–8 vite eksperiencë në projekte ndërtimi, preferohet në role teknike ose menaxheriale.
- Njohuri të avancuara në AutoCAD, MS Project, MSC Office dhe programe të tjera teknike.
- Përvojë në menaxhimin e dokumentacionit teknik dhe koordinimin e projekteve.
- Njohuri të standardeve të ndërtimit dhe legjislacionit teknik.
- Aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi.
- Aftësi për të menaxhuar ekupe dhe për të punuar nën presion.
- Eksperiencë në projekte të mëdha ndërtimi (rezidenciale ose industriale).
- Të jetë i gatshëm të punojë / jetojë jashtë Tirane.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dërgojnë CV nëpërmjet adresës së e-mailit careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 03 Prill 2026, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.